

**Trepça Shoqëri Aksionare**  
**Trepça Joint Stock Companies**  
**Trepça Deonitarsko Društvo**

Nr. 2848 Data 02.04.2026  
Mitrovica Mitrovica



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të Ligjit nr.03/L-212 të Punës neni 8 dhe neni 10 paragrafi 2 nëparagrafi 2.2, nenit 22 paragrafi 4 i Statutit të Trepça Sh.A., nenit 8 paragrafi 2 të Rregullores për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A., si dhe bazuar në Rregulloren nr. 4249 të datës 03.08.2023 për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë, Trepça Sh.A me datë 02.04.2026 publikon këtë:

## KONKURS

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

<b>Titulli i pozitës së punës:</b>	Përgjegjës i mullirit
<b>Koeficienti/Paga</b>	640€ bruto
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Kohëzgjatja e emërimit</b>	Në periudhë të caktuar (1 vjeçare me mundësi vazhdimi, puna provuese 6 muaj)
<b>Data e njoftimit</b>	02/04/2026
<b>Afati për aplikim</b>	03/04/2026- 17/04/2026
<b>Institucioni</b>	Ndërmarrja "Trepça Sh.A."
<b>Njësia Biznesore</b>	Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë

## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

- Zbaton urdhërat që i merr nga mbikëqyrësi i ndërrimit dhe udhëheqësit tjerë përkatës;
- E përcjell punën prej yjzive deri në rrjedhje të pulpës nga klasifikatori;
- Bashkëpunon me përdoruesin e yjzive;
- Bashkëpunon me përdoruesin e shiritit transportues nr 31;
- Bashkëpunon me mullisin;
- Përcjell dendësinë e pulpës në dalje të mullirit dhe në rrjedhje të klasifikatorit;
- Përcjell sasinë e xehes që hyn në mulli;
- Përcjell sasinë e materialit që e kthen klasifikatori në mulli;
- Kontrollon ngarkesën e mullirit dhe klasifikatorit;
- Përcjell lybrifikimin e mullirit dhe klasifikatorit;
- Bën kontrollimin e temperaturës në kushinetat e motorit të mullirit;
- Përcjell të gjithë parametrat e mullirit dhe klasifikatorit (për lëshuarjen e mullirit në punë dhe ndaljen e tij);
- E bën përgatitjen për lëshuarjen e mullirit në punë (duhet plotësuar kushtet për të lëshuar në punë mullirin);
- Mullirin dhe klasifikatorin i vën në funksion (i lëshon në punë dhe e bën ndaljen e tyre) Njësia e Mirëmbajtjes Elektrike;
- Në raste të veçanta (të rrezikshmërisë), mullirin dhe klasifikatorin e ndal mbikqyrësi;
- Pranim-dorëzimi i punës duhet të bëhet në vendin e punës;
- Është i obliguar të respektoj orarin e punës;
- Obligohet t'i përdor mjetet mbrojtëse për vendin e punës dhe zbaton rregullat e mbrojtjes dhe sigurisë në punë;
- Angazhohet edhe në vende tjera të punës, sipas nevojës;
- Duhet të punoj edhe jashtë orarit të punës, sipas nevojës;
- Për zbatimin dhe mos zbatimin e detyrave të punës i nënshtrohet masave stimuluese dhe ndëshkuese, sipas rregullores së punës.

## 2. Kriteret e përgjithshme

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një vepre penale;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me ligj.

### **3. Kriteret e veçanta**

---

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme ose mesëm të ulët;
- Duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale.

### **4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit**

---

- Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Deklarata nën betim (e cila shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Dëshminë e përvojës së punës profesionale;
- Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është i dënuar për veprë penale apo nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- CV-Biografia;
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjet e dokumenteve mbi kualifikimin arsimor dhe / ose nostrifikimin për diplomat jashtë vendit.

### **5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve**

---

- a. Testimi me shkrim – 100 pikë
- b. Intervista – 300 pikë

### **6. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët**

---

- Përmes e-mail dhe ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.” në linkun <https://trepcasha.com/>, tek kategoria Shpallje.

## 7. Mënyra e aplikimit

---

- Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zyrën e protokollit të Trepça Sh.A., në Menaxhmentin e Trepça Sh.A.-Parku Industrial në Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00.

## 8. Shpallja e rezultateve përfundimtar

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.”.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

